INDIVIDËT - Fletëparaqitjes duhet t'i bashkëngjiten dy faqe (max. 1500 fjalë) përmbledhje rreth objektit, Curriculum Vitae (përfshirë detajet mbi botimet e mëparshme) si dhe dy letra rekomandimi të cilat mbështesin projektin tuaj individual apo grupor.

GRUPET. Fletëparaqitja duhet të plotësohet dhe të sillet nga udhëheqësi i grupit. Në të krahas informacionit bazë për projektin duhet të përfshihet dhe lista e emrave të individëve të tjerë të përfshirë në objekt si dhe informacionin mbi punën e tyre akademike dhe institucionale. Gjithashtu duhet bashkangjitur nga një letër nga çdo individ që pranon të punojë me trupin.

DOKUMENTAT E PLOTESUARA DUHET TE PARAQITEN DERI ME 15 SHTATOR 1992.

Për informacion të mëtejshëm dhe për fletëparaqitje ju lutemi kontraktoni Ibrahim Gashin pranë fondacionit «Shoqëria e Hapur» për Shqipërinë, Qendra Ndërkombëtare e Kulturës, Dhoma 28 Tiranë, ose telefoni në 34 223 ose 34 821.

Programi i TVSH

12.00 TV-Mesditë; 12.05 Satelit- Mirëdita të rinj (Program i drejtpërdrejt); 14.30 Filmi i mesditës; 16.00 TV SOT; 16.30 Gjuha angleze në TV (Mësimi nr. 2); 17.00 Ekonomi. Përvoja nga Franca; 17.30 Filmi «Libri i mrekullueshëm» (pjesa e 10); 18.00 Tv Sot; 18.05 Satelit; 19.00 Nga festivali i parë i SHKA se shqiptarë të maqedonisë; 19.30 Telenovela «Një jetë tjetër» (Pjesa 65); 20.00 Telerevista; 20.30 Film Artistik «Ethet e arit»; 21.05 Orë argëtuese për ju; 22.05 Lajmet e mbrëmjes; 22.25 Teatri në ekran «Dasëm gjaku»; 24.00 Mbyllja e programit.

RD
RILINDJA DEMOKRATIKE

Qysh kur në horizontin tonë politik u zbulua «ylli» Fatos Nano, temperatura e klimës sonë politike u ngrit me shpejtësi e pandërprerje. Kjo është rrjedhojë e egoizmit dhe cinizmit të tij të lindur, që u bënë shtrat i gjërë e i fortë edhe për karrierizmin e aventurizmin e tij si politikan e qeveritar. Profesorët e tij, Ramiz Alia dhe Nexhmije Hoxha, që ia njihnin dhe ia kishin kultivuar këto cilësi të trashëguara, i besuan misionin e çuarjes deri në fund të veprës së tyre monstruoze antikombëtare e antidemokratike, për të ruajtur me një plastikë të lehtë diktaturën e vjetër.

të drejtën të jepte urdhër. Kështu analize, urdhërdhënësi mbetet të je

Me euforinë e fitores së 31 marsit në fre egërsisë së tij të natyrshme, shtyrë drejt urdhërit (qëlloni pa më kratët, t'u japim një mësim të mir harrojnë tërë jetën».

Por urdhërpërcjellësit apo urdh tin me dëshirë apo kërcënime për të hur fajtorin e madh. Heshtja e ty zvarritja e gjyqit të Shkodrës edh jepet nga maja e piramidës së PS.

KUSH ESHTE URDHERDHËN PËR MASAKREN E 2 PRILL

Zënia për pak kohë e kolltukut kryeministrial e bëri edhe më të papërmbajtur në ambiciet e tij, e dehu aq shumë sa ta ndiente veten Zeus të plotfuqishëm që të bën gjëmën. Këtë e provoi me shumë dhimje e hidhërim populli i Shkodrës me 2 prill 1991. Po bëhet një vit e gjysëm që nënat, motrat e katër martirëve po shkrihen nga lotët e zemrave, por Ramiz Alia, Fatos Nano e Gramoz Ruçi, bredhin të lirë në vend e në botë, duke sfiduar hapur demokracinë.

Duken absurde, të pajustifikueshme as në planin e brendshëm e atë të jashtëm, as në të mirë të vetë PS e të kombit, egërsia e kryqëzatës antidemokratike që udhëheq Fatos Nano e padurimi i tij për të rrëmbyer përsëri pushtetin. Opinioni i përgjithshëm në vend e në botë është i mendimit se për katër vjet kësaj partie i bëhet shumë mirë të qëndrojë si opozitë konstruktive, sepse kështu mund të rinovohet me të vërtetë, mund të përmirësojë imazhin e keq të deritanishëm si forcë antikombëtare, e paaftë për të qeverisur e për ta nxjerrë vendin nga humnera ku e hodhi po ajo.

Mos vallë Fatos Nano po përjeton një dramë shekspiriane për mëkate që ka bërë kur ishte në pushtet e tani është gati të bëjë çdo gjë vetëm t'i shpëtojë ndëshkimit të merituar?

Mos vallë ky mëkat lidhet me 2 prillin 1991 të Shkodrës?

Me 2 prill 1991 vetëm ata tre vetë kishin plotfuqishmërinë për të dhënë urdhërin që të qëllohej mbi popullin e paarmatosur, Ramiz Alia, Fatos Nano e Gramoz Ruçi. Alternativa është e qartë: ose janë tre urdhërdhënës, ose njëri. Në qoftë se kanë vendosur e urdhëruar me një zemër, mendje e gojë, janë përgjegjës e duhet të mbajnë përgjegjësi të tre. Në qoftë se është njëri, dy të tjerët, ta denoncojnë për të çliruar veten nga barra morale e ligjore e krimit, për të bërë vetëm një akt pendese e sinqeriteti. Po cili është ai? Ramiz Alia? Si president e kishte të drejtën e urdhërit. Por, duke njohur natyrën e tij odisejane, frikën dhe faktin se

bëhet shpejt e fajtori i vërtetë do t sepse peshqit e vegjël nuk do të pr sakrifikohen për peshkaqenët e mëd shta e torturon Fatos Nanon. Por nga ata njerëz që nuk e presin duar gjunjëzuar fundin e tyre. Për të shpë e tij meteorike, duke shfrytëzuar m demagogjinë e të parëve postin që k përdor si kokë turku partinë që drejt ratin që manipulon ajo sipas zanatit

Për ta vonuar sa më shumë ditën të madh apo të fundit të turpshëm të menëve të tjerë, e ka ngritur në këmb po e udhëheq në kryqëzatën e ethshm për të sabotuar reformat e Qeverisë për të destabilizuar rendin deri në një apo gjakderdhje masive, për të rifitu humbur. Duke e ndier veten në ceitn ekuilibër e logjikë aq sa të lejojë p hore të ngjarjeve në Poliçan me Konf ndrës të 26 gushtit. Megjithatë mesazh nga Poliçani kuptohet lehtë «tani që rbia le të sakrifikohet Shqipëria».

Por, duke qënë i brumosur nga pë enveriane e ramiziane, ai di të ruajë t'i nxjerrë gështenjat me duart e të t gjitha rastet kur PS është zbuluar e de si forcë destruktive e antikombëtare ai në skenë. Edhe në debatet për ngjarje ai mungoi. Natyrisht kjo i ngjan vepr dit që fut kokën në rërë. Gjurmët e me skenarit të tij zbulohen lehtë në Poli Ilir Meta është vetëm një gur shahu në Dhe sa kohë do të vazhdojë Fatos N shtrojë masën e socialistëve dhe të das ndershëm, idealistë të PS?

Dy vjet janë shumë për t'u bindur se kujt i shërben dhe sa të rrezikshëm ja e kombit e të demokracisë sëmundja e rueshme e karrierizmit, cinizmi dhe ligë nstruoze, vendosmëria e tij për ta ver

dent e kishte të drejtën e urdhërit. Por, duke njohur natyrën e tij odisejane, frikën dhe faktin se ishte shkodran, mundësia për të qënë ai urdhërdhënësi është e diskutueshme.

Përpara atij dhe kryeministrit Fatos Nano, Gramoz Ruci nuk mund të merrte guximin e nuk kishte

nstruoze, vendosmëria e tij për ta
kun edhe mbi kufoma e giak-
Natyrisht, qënia e tij si urdhë
tani është hipotezë. Gjyqi do të zbu
XHE

NJOFT

Mbi kontrollin për aktivitetin ligjor «ADA

(Vijon nga faqja 1)

ca për shfrytëzimin e tyre për arsye se janë vërejtur mjaft parregullsi e shkelje ligjore, po përmendim:

Së pari, ky studim është bërë pa prezencën dhe kontrollin e palës shqiptare, si pasojë nuk dimë çfarë sasie koralesh janë nxjerrë nga deti e sa janë dërguar për studime jashtë shtetit. Po ashtu nuk dimë çfarë gjërash me vlerë mund të jenë marrë nga fundi i detit.

Së dyti, në këtë aktivitet u vërtetuan falsifikime e mashtrime më konkretisht.

- Kërkohet licenca përkatëse ish-Ministrisë së Ushqimit duke deklaruar se janë marrë leje nga drejtoria e kufirit kur ato efektivisht nuk qenë siguruar.

- Kërkohen lejet përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes për të operuar me motorskafin dhe me një automjet gjatë bregdetit duke deklaruar se kanë marrë licencën për studime e eksplorime në naftë duke fshehur të vërtetën mbi koralet e për më tepër nuk ishte siguruar licenca të cilën e ka marrë më vonë.

Kjo lloj praktike me bazë mashtrimi është metodë pune në veprimtarinë e kësaj ndërmarrje.

- Në autorizimin e lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes për lejimin e një automjeti francez të cilit i jepet e drejta për t'u futur «Në territorin e porteve kufitare bregdetare» fjala «porteve» është fallsifikuar dhe shkuajtur «reparteve». Në këtë mënyrë kanë siguruar që motorskafi të qarkullojë gjithë bregdetin shqiptar nga jugu në veri, shoqëruar në tokë nga automjeti. Vetëm ky fakt të çon në mendimin se në bashkëpunimin e këtyre dy mjeteve mund të bëjë çdo lloj kontrabande, cigaresh, vjedhje amforash e vlerash të tjera nënujore etj. Motorskafi në fjalë është lënë nga kapiteneria e porteve të qarkullojë në ujrat territoriale tona edhe pas përfundimit të afatit të licencës. Për këtë problem është mbajtur akt verifikimi me kapitenerin e Portit Sarandë ku vërtetohet se personeli i motorskafit ka bërë zhytjen në këtë territor gjatë muajit maj 1992 pa asnjë licencë. Nuk dihet asgjë dhe për këtë rast çfarë mund të jetë marrë nga fundi i detit. Nga kapiteneria e porteve pjesëtarëve të ekuipazhit janë paisur me matrikull lundrimi, mbi këtë bazë ky motorskaf është lejuar të shkojë në Itali dhe në Korfuz.

Pronësia e motorskafit është e pavërtetuar mbasi ndërmarrja «ADA» nuk ka paraqitur dokumenta pronësie me gjithë kërkesat tona të vazhdueshme». Lëvizja e motorskafit prej 2 muajsh është bllokuar nga ana jonë.

Grupi i kontrollit e pati të pamundur të bëjë revizion të plotë financiar pasi në këtë ndërmarrje nuk është nxjerrë bilanci kontabël që nga krijimi i saj deri më sot. Në amullinë që ekziston jo vetëm që është lënë shteg i hapur për abuzime e shpërdorime, por dhe për maskimin e tyre. Mos kryerja e kësaj detyre përbën shkelje të nenit 11 dhe 34 të dekretit «Për veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve me pjesëmarrje të kapitalit të huaj» si dhe të kontratës e të statutit të vetë ndërmarrjes.

Kjo gjëndje është e njohur por Ministria e Financave ka qëndruar në heshtje ndaj këtij fakti. Po rendisim disa nga konstatimet e kontrollit tonë.

- Ka shumë boshllëqe në dokumentacionin flet-hyrje e flet-dalje si dhe azhornimin e tyre në kontabilitet. Për rr
më mallra nuk di
kulluar.

- Aktiviteti k
është bërë në sh
me para në dorë
rreth 40 milion
që nëpërmjet bank
prime vetëm për
Po ashtu transferi
bankat e firmat e
rë me para në d
1991 arrin shumë
rë, 95 000 lireta, m
hmi. Kjo mënyrë
byer për të fsheh
rezultatet financia

- Praktika tjetë
me është se shur
kë ose valutë, në
mjet bankës u m
ntat që pasqyrojn
ose me dokument
nuk justifikohet
punës së kryer.
shumën 350 000

- Nga zoti Mar
lton se ju janë
të ndryshëm me
radhënie mbi 10 3
rsa në valutë s
të pjesëshme rreth
rë, 95,4 milion li
lion dhrahmi, kjo
zhduar dhe gjatë

- «Dora e lirë»
parave vërehet dh
për dreka e dar
vitit 1991 shifra
850 000 lekë. Për
grupesh e miqsh,
janë shpenzuar m
llarë. Për vitin e
pako të veçanta
verisë, kryetarëve
tike (mbi 60 vetë
3600 dollarë.

**Ndërmarrja «A
dhe me aktiviteti
cigareve. Këtë l**

Gogoli diktaturë e djathtë dhe parti-shtet

(Vijon nga faqja 1)

madje disa liderë të tyre, më vonë do të duhet të lënë ato prona, që u përkasin të tjerëve?

Deri ristrukturimin e aparateve nga nëpunësit e kompromentuar, me stazh të gjatë pune pa ndryshuar sektor, të paaftë ose lidhje farefisnore me ish udhëheqjen e lartë të PPSH, shteti demokratik e miratoi me ligj. Pra, asgjë fshehtas e me urdhërin e «Zeusit», por hapur, duke diskutuar për ligjet e pastaj vendoset si do të veprohet. Këtu s'kemi pse të ngatërrojmë formën krejt demokratike, rrugën demokratike me faktin se edhe shumcia në ndonjë rast të caktuar e për ndonjë problem të caktuar mund të mos arrijë zgjidhjen më të mirë dhe efikase. Por, raste të tilla i gjen në çdo vend të botës, madje edhe në ato më me përvojë dhe jo tek ne ku na mungon si eksperienca edhe purizmi demokratik. Të mos harrojmë se pas 50 vjetësh diktaturë vështirë njerëzit e rritur të transformohen menjëherë në demokratë të kulluar, ashtu si po e shikojmë që edhe pse thonë, ish anëtarët e PPSH (një pjesë e caktuar) e ka të pamundur të shkëputet nga praktikat e nënës që i lindi.

Por rruga që ka nisur qeveria jonë dhe shtet demokratik, bashkë me Presidentin, është e mbarë është evropiane, është krejt demokratike dhe në të mirë të Shqipërisë. Prandaj gogoli socialisto-mocionist për diktaturë të djathtë ose parti-shtet është veçse një dashakeqësi, një mashtrim me qëllim për të zgjatur edhe më shumë vuajtjet e Shqipërisë. Kjo parrullë destabilizon, në një kohë që dihet mirë ç'sjellin këto acarime. Vetëm pse në Rostok të ish Gjermanisë Lindore pati konfrontim për problemin e refugjatëve, menjëherë shtypi gjerman njoftoi se kjo situatë jo e qetë do të largojë investitorët që duan të bëjnë ndërtime në atë zonë. E jo më kur e dinë se në një shet njëra palë kërkon të ndërtojë shtetin demokratik juridik, ndërsa pala tjetër, qoftë dhe më e pafuqishme, bën thirrje për ta zgjidhur vetë populli çështjen e bashkëqeverisjes e menjëherë pas saj shfaqet Poliçani.. Po përgjegjësia historike le të bjerë mbi ta e jo mbi partinë dhe partitë që po bëjnë çmos të hartojnë ligje demokratike që të kemi një Shqipëri me shtet ligjor bashkëkohor.

PETRO DHIMITRI

Të burgosurit e mirëfilltë politikë s'kërkojnë lëmoshë

Diskutimi i zotit Uran Butka në parlament për çështjen e të burgosurve politikë.

Është në nderin e qeverisë dhe të parlamentit të parashtrojë dhe të miratojë këtë projektligj për fondin e veçantë për ish të burgosurit dhe të përndjekurit politikë. Unë e përshëndes këtë akt legjislativ. Le të jetë ky një hap i parë. Presim që në parlament të vijë sa më parë edhe ligji i pafajësisë, që kemi kërkuar disa herë, i cili, në radhë të parë do të ligjërojë në mënyrë të plotë pafajësinë, do të verë në vend dinjitetin e qindra-mijëra kundërshtarëve politikë të komunizmit e të diktaturës makabre të Enver Hoxhës dhe në radhë të dytë, do t'u japë atyre gjithë atributet që rrjedhin nga ky ligj, por të mohuara e të grabitura poshtërsisht nga ish-pushtetmbajtësit e kuq. Vazhduesit e veprës së këtyre sot, socialistët bëjnë çmos që të mos u jepet të persekutuarve as pafajësia, as pronat e pasuritë që iu grabitën atyre në mënyrë të paligjshme, me dhunë, me fjalë në shtyp apo i mishëruar në veprime konkrete antidemokratike.

Të burgosurit politikë të mirëfilltë janë krenarë për të kaluarën disidente. Ata s'e kanë ulur kokën dhe s'kërkojnë lëmoshë nga askush. Të dalë nga varri, nga burgjet e kampet e internimit, në kushte të vështira ekonomike, ende pa shtëpi e punësim, ata janë më të qetët e më të vendosurit për demokracinë. Ja këtu në këtë Korçë takova para disa ditësh një ish-jurist të njohur, z. Kapshtica, ish i burgosur i Burrelit, në moshën afër 90 vjeç, që jeton në kushte shumë të vështira dhe që prej 15 vjetësh nuk merr asnjë lloj pensioni se është damkosur nga komunizmi me vulën e tradhëtisë. Megjithatë asnjë ankim, veç fjalë të mira për demokracinë dëgjojnë nga goja e tij. Ndërsa enveristët, socialistët dhe neosocialistët nxje-

sia e tij mo-
dosur kolltu-

ënës tani për
të vërtetën.
T MUSTAFA

internime të pashembullta antinjerëzore. Neve na indinjojnë njëkohësisht edhe qëndrimet hipokrite e demagogjike të neosocialistëve, të pseudodemokratëve të çdo ngjyre, ai përçmim i shprehur me

Osman Kazazi, që megjithëse shteti demokratik i akordoi dekoratën e parë të lartë «pishtar i demokracisë», ende mbart etiketimin socialist «kriminel lufte» që e pengon të marrë qoftë edhe pensionin. Në

IM

ë ndërmarrjes së përbashkët

lhojë për shu-
t si kanë qar-

esor bregdetar
icën e rasteve
për një shumë
ë në një kohë
janë kryer ve-
3,4 milion lekë.
i i valutës me
huaja është bë-
ë që për vitin
497 000 dolla-
3 milion dhra-
eprimi ka shër-
r veprimtarinë,
e të saj.
e jashtëligjsh-
ë pagesa në le-
dorë ose nëpër-
ngojnë dokume-
punën e kryer
t që disponohen
lefta në lekë e
Kjo praktikë zë
kë.
el Skëndo rezu-
dhënë personave
ara në dorë pa-
milion lekë, ndë-
pas të dhënave
478 mijë dolla-
eta dhe 7,1 mi-
praktikë ka va-
vitit 1992.
në derdhjen e
e në shpenzimet
ka. Vetëm gjatë
a arritur në mbi
pritje përcjellje
dhënie dhuratash
bi 11,6 mijë do-
ri u shpërndanë
anëtarëve të qe-
të partive poli-
që kapin vlerën

DA» është marrë
e tranzitimit të
oj aktiviteti e ka

kryer pa asnjë licensë nga janari deri në muajin maj 1991 kur së fundi e siguroi atë. Me këtë veprim ka shkelur vendimin e K.M. nr. 433 datë 10.12.1990 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave për doganën nr. 1 datë 16.2.1991, ndërsa doganat tona përpara këtij fakti kanë mbyllur sytë.

Problemi i duhanit po ndiqet pasi janë vërtetuar parregullsi si në sasinë e deklaruar në zhdoganim etj.

Ndërmarrja «ADA» nuk ka qënë korrekte me shtetin shqiptar për derdhjen e detyrimeve financiare. Në disa përllogaritje që morëm nga zyra e financës së kësaj ndërmarrje rezulton:

1. Të ardhura gjithsej 6.170.955 lekë.
2. Shpenzime 77.163.709 lekë
3. Fitime ose humbje 117.211.404 lekë
(+, —) 30.047.695 lekë

Po t'i besonim kësaj të dhëne, kjo do të qe përvoja dhe reklama më e keqe që mund t'i bëhej një ndërmarrje të përbashkët, aq më tepër kur ajo është marrë kryesisht me tregti të thjeshtë pa bërë investime kapitale që dhe mund t'i justifikonin këto shifra.

Për gjithë periudhën për 1,5 vjet ka përfituar nëpërmjet sistemit fiskal rreth 808,6 mijë lekë, 43400 dollarë dhe 13,9 milion lireta.

Gjatë kontrollit me metodën e inspektimeve u gjëndën një seri shkeljesh, dhe u arkëtuan në buxhetin e shtetit nga ana e ndërmarrjes «ADA»:

1. Taksë doganorë për mallra e makineri të pa tatuara 2.940.732 lekë
2. Tatim qarkullim mallrash 1.309.013 lekë
3. Sekuestrim dhe bllokim malli 1.533.100 lekë
4. Sig. shoqërore për punonjësit 388.100 lekë

Ndërmarrja «ADA» aktivitetet e mirfillta tregtare që ajo ka paraqitur në statutin e saj kanë shërbyer si fasadë për të marrë me aktivitete të tjera duke përfituar nga lehtësia e ndërmarrjes së përbashkët, si dhe në veprimtarinë e saj drejtuesit e kësaj ndërmarrje kanë shfrytëzuar të gjitha boshllëqet e legjislacionit shqiptar në këtë periudhë tranzicioni, për të nxjerrë fitime në rrugë spekullimi.

Për të gjitha këto përgjegjësia kryesore bie në radhë të parë mbi z. Marsel Skëndo i cili ka ndikuar për keq në emrin e ndërmarrjeve të përbashkëta dhe me pasoja për qëndrimin ndaj firmave të huaja aq të nevojshme për vendin tonë. Kanë përgjegjësi shumë institucione shtetërore si dhe ish-drejtues p.sh.: Besnik Kapo, Ylli Çabiri, Ilir Mataj, Altin Ylli etj. Analizë e hollësishme është bërë në aktin e kontrollit. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura çështja u dha për ndjekje penale.

Mendojmë që të merren edhe këto masa:

1. Të shfuqizohet menjëherë vendimi i K.M. nr. 371 datë 20.10. 1990 për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët «ADA».

2. Të largohet nga detyra Ilir Mataj, Ylli Çabiri, Besnik Kapo, Sadulla Elezi dhe Bashkim Caka, të jepet vërejtje z. Altin Ylli.

3. Komisioni i Kontrollit të Shtetit të fillojë kontroll-revizion në drejtorinë ekonomike të Ministrisë së Rendit për të gjithë lidhjet që dalin nga ndërmarrja «ADA» dhe për tranzitimin e cigareve.

4. Secila ministri në linjën e saj të kontrollojë aktivitetin e ndërmarrjeve të përbashkëta dhe të sjelli konkluzione në Këshillin e Ministrave.

KRYETARI
BLERIM ÇELA

ish të burgosurit e të përndjekt
politikë, tremben, i quajnë ekst
mistë etj, etj., ndonëse ish - të
rgosurit e ndërgjegjes deri tani s'k
në bërë asnjë akt dhune, asnjë
ses, asnjë dëm, por vetëm mbë
tetje zhvillimeve demokratike!
rkundrazi akte dhune, terroris
shkatërrime e destabilizim ka
kryer forcat e errëta e të egra
cial-komuniste që kanë humbur
po humbasin çdo ditë terren
shpresë për restaurim.

Por ne nuk jemi dakort dhe k
ndërshtojmë edhe ndonjë cung
apo zgjidhje gjysmake të çësht
ve të të burgosurve politikë, q
të edhe nga ana e qeverisë. Kë
ditë Ministria e Financave nxo
një udhëzim për zbatim të lig
të pafajësisë miratuar vitin e k
luar. Këtu thuhet se pronat,
cilat u janë konfiskuar ish të pe
sekutuarve politikë dhe që u ja
kaluar të tretëve (shtëpitë etj),
mos u kthehen këtyre, po t'u jep
vlefta në lekë... Domethënë t'i mb
jnë ish persekutorët që të m
shqetësohen e të mos u prishet
jfi! Ndërsa ish pronarët e ligjshë
të mos marrin as pronat person
le - shtëpitë, mbasi u vranë, u i
ternuan e burgosën për gjysmë sh
kulli me radhë. Kjo është e papr
nueshme dhe fyese! Ligji i pafaj
sisë dhe i kthimit të të gjitha
drejtave të mohuara morale e m
teriale ish të burgosurve e të pë
ndjekurve politikë është emergje
detyrë e shtetit demokratik dhe
lëmoshë apo «llokum me dinami
siç shprehet z. Legisi. Fryma
diskutimit të z. Legisi dhe z. Ru
etj, është sa injorante aq edhe m
huese. Ata formalisht e pranojn
ndërsa me ndërgjegje (siç e poh
an edhe vetë) nuk e miratojnë.
Shqipëri, komunizmi solli atë tr
gjedi të paparë, ishte aq i përgj
ktë dhe i veçantë sepse u bashk
me injorancën. Këtë simbiozë
bashkëveprim e shohim edhe s
bile edhe të shfaqur këtu në pa
lament.

Po ashtu kundërshtoj shpërth
min nevrastanik e të papërmba
tur të z, Kastriot Islami. Kjo rrje
nga formimi i tyre politik. U
po ju them në këtë rast se Qev
ria këtë vit shkollor po ju jep
për qind zgjidhje kërkesave p
shkollim të lartë të fëmijëve të
përndjekurve politikë. Ja pra
hap tjetër konkret në zgjidhjen
problemeve të tyre nga qever
demokratike. Le të na akuzoj
më kot disa pseudodemokratë p
demagogji në çështjet e të burg
surve politikë. Ata janë vetë sp
kulatorë e demagogë.

URAN BUTK

Kërkoj si nënë...

Më datën 1 prill 1990, djali im i vetëm, Përparim Pashako, 30-vjeçar me detyrë shofer në Parkun e Autobuzëve të Parkut të Turizmit në Tiranë pasi u pushua nga puna padrejtësisht në nëntor 1989 nga drejtori i atëhershëm dhe mbas 2 gjyqeve - të dyja u fituan nga drejtori. - Si dhe pasi qëndroi rreth 6 muaj pa punë, së bashku me një shokun e tij, Engjëll Çako, të udhëhequr nga një «udhërrëfyes» u nisën për t'u larguar (arratisur). Në Postën e kufirit në Sminac të Sarandës u kapën të gjallë, që të dy, djali im, Përparimi dhe shoku i tij, Engjëlli. Në operacionin për kapjen e tyre (operacion që drejtohej nga Drejtoria e P. Brendshme të Tiranës), forcat e kufirit me 2 oficerë, 12 ushtarë dhe 2 qen kishin bllokuar kufirin një ditë më parë, pra më 31 mars. «Udhërrëfyesi» u kthye, kurse Përparimi dhe Engjëlli kaluan brezin kufitar dhe u kapën që të dy të gjallë. Si u lidhën me litar të shoqëruar me një tufë ushtarësh, oficerësh dhe qen, i shpunë në postën e Sminacit. Engjëlli u suall i gjallë në Sarandë e të nesërmen në Tiranë në Drejtorinë e P. Brendshme (tek Florjan Kolaneci), kurse djali im, Përparimi, u vra gjoja sepse ëntoi për të rrëmbyer armën e ushtarit. Kjo është krejt e pabesueshme dhe jashtë çdo logjikë. Si mund të besohet që personi i raskapitur, i lodhur dhe i shoqëruar prej një numri ushtarakësh të armatosur dhe me qen kufiri të tentojë për këtë veprim?

Kam 2 vjet e më shumë që kërkoj eshtrat e tim biri, por nuk m'i kanë treguar. Kryetari i Degës P. Brendshme Sarandë pretendonte se nuk dinë gjë, sepse këtë operacion e ka ndjekur Drejtoria e Tiranës. Drejtoria e Tiranës më përcillte në MPB. Këta në Hetuesi. Hetuesia

Ngatërresa «të vogla» në demokraci

Tërë vështirësia qëndron tek të kuptuarit e gjërave, në ndryshimet mes tyre. Tranzicionet këtu e kanë sheshin e luftës, në transferimin e mënyrës së të jetuarit. Në një mjedis ku kapitalizmi vetëm është mallkuar, nuk duhet pritur që ardhja e tij vetëm të duartrokitet, ashtu si ikja e sockomunizmit. Kalimi nga njëra gjendje të tjetra, pritshëm shoqërohet nga «ngatërresa» jo të pakta, madje jo aq lehtë të neglizhueshme:

1. Në një shtet dhe ekonomi tepër të centralizuar gjithçka pritej prej tij. Sepse ai i mirrte të gjitha. Prandaj, Ai kishte në dorë jetët dhe vdekjet, gëzimet dhe vuajtjet tona, varfërinë dhe ëndërrimet tona. Tani synohet tjetër shtet: një shtet aq i fuqishëm sa individi të mos trëmbet prej tij, një shtet aq i pasur sa individi me inisiativë të mos varfërohet prej tij. Një shtet që të mos garantojë shumë gjëra, por që të bëjë të mundëshme vetëgarantimin e tyre.

Por ja që ne, se përse, vazhdojmë të «ngatërrohemi»!

«E duam shportën jo me 5, por me 10, me 13... zëra!», «Nuk duam papunësi», «Nuk duam rritje çmimesh»...!

Barazia në varfëri nuk po na shqitet! Të kemi të gjithë njëlloj, të vishemi të gjithë njëlloj, të kemi punë të gjithë, të shkojmë të gjithë... të gjithë, të gjithë të pasur në kapitalizëm, meqë këtë nuk e bëmë dot në komunizëm! Pra: të na udhëheqë po ajo mendësi e komunizmit. Garanci nga shteti (por jo taksa e tatime prej tij.), paga të larta (por jo çmime të larta ekuivalente), ekonomi tregu (por me planifikim allasocialist), kompensim deri në një i gjithë çmimeve të rritura.

Atëherë, ku ishim e ku shkojmë?! Ku është «arsyeja», shtysa që njerëzit të punojnë? Kush do t'i provojë aftësitë e veta, të drejtën për të fituar më shumë se ata në krahë? Ku do lindin kapitalistët tanë, a do të pajtohemi ne të tjerët në fabrikat e uzinat e tyre, apo do të bëhemi të 3 milionët me fabrika dhe uzina, të gjithë milionerë?.!.

- Kapitalizëm, zotërinj... Jo kapitalizëm socialist! -

2

Në «ZP» vazhdojnë ta përdorin rubrikën «Nga letrat e popullit», tamam siç e niste sh. Enver dikur: duke shfletuar letrat e popullit! Ne do bëheshim me faj sikur këtu të bëhej fjalë për hallet dhe zgjidhjet e tyre për popullin. Por e vërteta duket acik kur merr vesh mesazhin shoqëror të këtyre lerave!

Në një varg syresh, që më parë botohen në «ZP» se të arrijnë te presidenti, i kërkohen këtij të

nuk dinë gjë, sepse këtë operacion e ka ndjekur Drejtoria e Tiranës. Drejtoria e Tiranës më përcillte në MPB. Këta në Hetuesi. Hetuesia në Ministrinë e Drejtësisë. I kam drejtuar letra ish-ministrit të Drejtësisë, të famshmit Enver Halili, sepse edhe ai nuk pranoi për të më takuar.

Në dyert e ish-qeveritarëve, të ish-kryetarit R. Alia kam vajtur me dhjetëra herë, kam kërkuar të vërtetën por, jo vetëm që s'm'u dha asgjë, por, përkundrazi, nga Simon Stefani, Florian Kolaneci, Zef Lokja dhe ndonjë tjetër edhe më kanë poshtëruar duke më konsideruar si nënë të një tradhtari.

Me anë të kësaj letre kërkoj nga Presidenti i Republikës, i nderuari prof. dr. Sali Berisha, nga Kryetari i Parlamentit, z. Pjetër Arbnori, dhe nga Ministritë e Drejtësisë, Rendit Publik dhe SHIK-u që:

1. Të vërtetohet se im bir është vrarë mbasi është kapur i gjallë nga persona të ish-MP Brendshme, simbas urdhërit të dhënë nga kryekriminelët R. Alia dhe S. Stefani.

2. Më qënë se në rrugë private kam gjetur vend-varrimin dhe eshtrat e djalit tim të dashur, kërkoj të më sillen në Tiranë, për ta varrosur pranë të atit, që e ka lënë jetim 8-vjeçar.

3. Të dalë hapur se cilët janë ata kriminelë të ish-Drejtorisë së P. Brendshme të Tiranës që kanë marrë pjesë në zbatimin e këtij operacioni të provokuar dhe të merren masa simbas ligjeve të shtetit juridik që ka vendosur demokracia.

4. Të dalë se kush janë ata kriminelë që pasi e kanë vrarë, i kanë vjedhur sendet personale dhe të hollat. Unë jam fukara, me një pension minimal dhe një qind lek për mua janë një shumë e madhe, por vleftën e sende dhe të hollat do t'ia fal kryqit të Kuq Shqiptar.

SADETE PASHAKO,
nënë

REKLAME

Firma «INTRA AG»

Firma «INTRA AG» Tiranë ju afron të gjithë klientëve shqiptar automjete të të gjitha llojeve nga 2-40 ton si dhe autobote, mikrobuza etj. të tipeve «BENZ», «VOLVO», «MAN», etj.

TË GJITHË TË INTERESUARIT MUND TË MARRIN ME TELEFONIN 230-90.

am papunësi», «Nuk duam rritje çmimesh»...!

Barazia në varfëri nuk po na shqitet! Të kemi të gjithë një-

të këtyre lerave!

Në një varg syresh. që më parë botohen në «ZP» se të arrijnë te presidenti, i kërkohen këtij të

Një po
kurrë njerëzit

Me respektin që të përcjellë njeriu që ka qenë i dënuar i ndërgjegjes, për të cilin një pjesë e mirë e rinisë dhe jetës u bllokua në një pikë të hapësirës, me respektin që të përcjellë njeriu që me arsyetimet e tij përpiqet të jetë sa më racional, analitik, ilustrues dhe përgjithësues lexova. zoti Fatos, artikullin tuaj «Shqipëria përballë një udhëkryqi të rrezikshëm». Besoj se ky respekt nuk ma heq të drejtën të dialogoj apo të mos pajtohem me disa prej pohimeve apo bindjeve tuaja që zenë vend në këtë artikull. Kur dy individë ose grupe individësh kanë bindje të ndryshme për të njëjtin objekt të diskutimit, unë them se dialogu është i mbarë.

Mund të pyesni pse fillova tani të shkruaj dhe pse u bë artikulli juaj shkak për këtë gjë.

Përgjigja është e thjeshtë: së pari çdo veprimtari ka një fillim dhe së dyti, se ky shkrim dhe shkrime të tjera të tuaja kanë pretendimin të jenë mësime demokracie për politikanët, intelektualët, për partitë, për presidentin, etj. Cilidoqoftë pretendimi apo mesazhi që kërkoni të na përcillni me anën e tyre unë gjej papajtueshmëri me disa prej ideve dhe arsyetimeve tuaja.

Së pari, nuk pajtohem me atë që vështrimi kritik e hidhni vetëm te një forcë e re politike PD, së cilët koha i dha legjitimitet historik. Eshtë e vërtetë se si forcë e re që është i mungojnë disa cilësi që do ta bënin atë më të konsoliduar. Vërtetë në këtë kanë hyrë edhe karrieristë, edhe individë të paaftë, edhe ndonjë revanshist. Të gjitha këto i solli një rritje numerike tepër e shpejtë dhe e pakontrollueshme. Por më thoni, cila parti e re ose e vjetër është e imunizuar nga gabimet e kësaj natyre? E keqja është se ju jeni të interesuar të analizoni njërin pol të magnetit, pa e parë atë në bashkëveprim me tjetrin dhe e keqja më e madhe është se ju këtë pol doni ta zhdukni fare. Si çelës magjik për këtë zhdukje juve ju duket largimi i presidentit nga interesat partiake. Por, dihet, se sado herë që ta ndash një magnet, në çdo copë të tij janë të pranishme të dy polet. Dhe poli tjetër i këtij magneti është PS. A nuk shikoni ju te kjo Parti disa qëndrime joparimore, bile paradoksale? Në fillim PS e ka akuzuar PD se e drejtojnë disa ish-komunistë, karrieristë, që nuk përmbajnë kurrfarë vlere opozitare. Pikërisht këta njerëz që janë sharë mbarë e mbrapsht për një kohë të gjatë. Tani kur këta ish-komunistë i kanë pozitat e lëkundura në PD, merren në mbrojtje duke i shpallur ata demokratë të vërtetë! Për PD thuhet se e ka dominuar ekstremizmi i djathtë. Pastaj thuhen fjalët «ne jemi gati për koalicion». E provuam edhe koalicionin. Sa herë ndodhte ndonjë turbullirë apo mungesë ushqimore socialistët ankoheshin se pushtetin «defacto» e ka PD. Një ministër i PS shpallej antireformator kurse zëvendësministri i tij reformator i vendosur, etj. etj. Zgjatja në këtë varg arsyetimesh është e kotë. A nuk duhet kritikuar PS që në shtypin e saj nuk merret fare me denon-

RD
RILINDJA DEMOKRATIKE

ëra, të cilat mund t'i
dikur E. Hoxhës apo
ur presidenti Berisha
vend pas një radhe
omuniste! Sikur të
stem shoqëror si i
zgjidhjet të atij llo-
në emër të barazisë
emër të unitetit dhe
dëshmorët (që dha-
liri dhe jo për dik-
emër të pronës së
he moralit të lejfeni-
!
ë është një kohë tje-
tët nuk janë më në
presidenti nuk është
or i Republikës së
Një letërshkrues i a-
ndi se ai kishte pri-
ë të diasporës! (Në të
dhuri më në fund në
et, i dënuar me mër-
ruar, foli vetëm për
në një drejtësi të
dhe jo për revansh).
fasuar që S. Berisha
gura atdhetare, të ci-
sideruar nga diktatu-
e si armiq të popullit
të pushtetit popu-
u për etiketë të de-
i nuk mund të mos e
të tillë. Jo që demo-
për të gjithë «kthim
së nëpërkëmbur». Aq
r shqiptarët e diaspo-
shumë për antikomu-
notshëm të cilët mbe-
jetën shqiptarë, patri-
a asnjë mëdyshje në
ndaj pushtuesve të hu-
boracionistëve të tyre.
rpiqemi të mos ngatë-
ne qëllim!

«PATRIOTIZMI ESHTE STROFKA E FUNDIT E HORRIT»

ULIAM BLEJK

Slloganët politikë mbi patriotizmin, arritën kulmin në intervistën e dubël-diktatorit Ramiz Alia, në gazetën e ish-partisë së tij P (K,P,S) «24 orë». Nuk ka të bëjë me sensacione, por me balet politik, në emër të «interesave të larta të atdheut». Për hir të këtyre interesave R. Alia i shërbeu me besnikëri të pashoqe diktaturës dhe E. Hoxhës; për këto interesa ai zëvendësoi denjësisht E. Hoxhën; e çoi Shqipërinë në greminë ekonomike e politike, për hir të atyre interesave thelloi luftën e klasave, zgjati diktaturën, izoloi më tej Shqipërinë; skicoi 2 korrikët, 2 prillët, 4-6 marset... për hir të këtyre interesave u zgjodh demon monist e pluralist i Shqipërisë, i dha fitoren PP më 31 mars, u rizgjodh president, dha dorëheqje... Përkushtimi i tij ndaj interesave të atdheut, është aq i madh, saqë mund të thuhet se edhe kur han ose pin diçka, e bën këtë, për interesat e atdheut!

I përndjekur nga hijet e krimeve politike të së kaluarës, i ngacmuar nga sulme të pakta gazetareske, R. Alia vesh kostumin e patriotit dhe telefonon misionarët e «24 orë»-ës, Po atë ditë që ish-kolegët e bashkëpunëtorët e R. Alisë jepeshin për gjykim para drejtësisë, Alia sfidon ecejaket e drejtësisë shqiptare dhe me oreksin e patriotit, flet zemërdjegur për «çështjen shqiptare». Në opinionet e politikës shqiptare për çështjen kombëtare, Alia shfaqet si një ëngjëll i urtë, që vuan padrejtësitë e shekullit, duke harruar se vetë ai është përgjegjës direkt i zhvillimeve të ashpra në pjesët e Shqipërisë së ndarë, sepse ai ishte komisar i shtetit mëmë shqikosovarët dhe gjithë shqiptarët në botë, që inkurajoi politikën e terrorit serb në Kosovë, që mbylli për 50 vjet kufirin, që burrat e shquar të kombit, i cilësoi tradhëtar dhe u mohoi atdheun, që përgjaku dhjetra të pafajshëm, të cilët tentuan të kalojnë nga Shqipëria në Kosovë...

Alia deklaron se s'mbrohet Kosova me mitingje me 150-200 vetë! Po kush, veç atij, kultivoi me vite me rradhë ndjenjën antikosovare! Ishte ai që solli që para pluralizmit ca ordinerë-afaristë, që flasin shqip, po s'dihet se ç'janë, duke ia servirur popullit tonë si përfaqësues të Kosovës! Alia kritikon pse s'u bë Kuvendi i Pajtimit! Po kush të pajtohet mes njëri-tjetrit? Cili fajtor kërkoi falje për krimet e veta? A mund të pajtohen 500--600 mijë të persekutuarit e ndërgjegjes, me ty dhe elitën tënde, që u morët jetën, shpresën, ëndrrën? Ç'pajtim mund të bëhet, kur skicues i çorbës së helmosur, është vetë R, Alia, nxënësi i urtë i arkitektit të sistemit nazist të E. Hoxhës?

Baleti i R, Alisë s'ka të mbaruar. Persekutori i demokracisë, pasi pozon si themelues i demokracisë, thotë se qeveria e sotme, duhet të tregohej më aktive...; Kur S, Berisha më 12 dhjetor 1990 do të lëshonte thirrjen e vdekur 50 vjeçare për bashkim kombëtar, R. Alia PP dhe «ZP» e akuzon atë si lider fashist! Ndërsa sot R. Alia, me paturpësi, shfaqet si lektor i ndershmërisë!!! Paralel me Alinë, edhe pjella e tij PS, PUK, PE, etj, me «ZP» e «24 orë», s'vonojnë të deklarohen me «zemër të vrarë» për Kosovën,, duke u

FARUK MYRTAJ | ptar, që e la Kosoven në mjet e harresës, që përçau emigracionin. | (vijon në faqen 4)

ulli nuk i mungojnë aftë

polemikë okun Fatos ja)

en akt tradhtie ndaj atdheut? Të ligjet e diktaturës qenë të rënda, mjaftonte kjo, shumë individë që t e diktaturës i kanë deformuar tetari ynë nuk dinte si të ruhej grackën e tyre. A nuk ka vend t të jenë objekt kritikash e spa- ohin luftën kundër konservatorëve të majtë?

i takon sistemit që na imponci dytë i takon PP si forca e vetme ti me xhelozi e fanatizëm absurd i i tretë i takon ekipit udhëheqës e kjo parti dhe pastaj së fundi kemi fajin tonë që e duruam për këtë sistem, paaftësia e të cilit ë. A nuk pati mjaft intelektualë, që me servilizmin, karrierizmin oniak i viheshin argumentimit te- e absurde. Unë e di që socialistët t'i mësoj unë. Taktika e tyre është e forcës numerike me çdo kusht, itit. A të çon në progresivitet kjo ë jo.

ajtohem me pohimin që politikanët ezi nxorri ky popull në këto kohë ë sot po ndahen nga PD. A thua bloc», janë më të kulturuarit më të aftit dhe më të moderuarit për lin tonë? Si ju duket, ju, qëndrimi është në krye të një gazete shkru- emokracinë, ndërsa kur e qarkulloj- të drejtë, menjëherë kujtohet të i PD i ngjet diktatorit dhe se de- shqet drejt diktaturës?! Po kështu, rimi i tjetrit që kur është «në ma- përdor termat e tij) pranon gjithë nsensus dhe pak durim kthesa eko- të e shpejtë, se do të ndihmojnë E- A, se dyqanet do të mbushen plot ndërsa, kur një ditë e sheh veten i ndërron fjalët duke thënë se qe- probleme, se kthesa është e largët, ënkan si në libra dhe së fundi, kur t u bë «i bezdisshëm» për atë ose ralajmëron se në Shqipëri po vjen politikë është shfaqur dueli veri- ë e ngjashme ndeshet edhe kur bë- zgjedhjen e Kryetarit të Parlamen- nga kryesia e Partia për këtë post hidhet poshtë nga Këshilli Kombëtar por për të mendohet që të qëndrojë në postin e nënkryetarit. Një gjë e tillë nuk pranohet nga ai. O kryetar o ra- shë e vdiqa. Dhe kujt mezi iu hap rruga për Krye- tar? Rruga iu hap, P. Arbnorit njërit prej intelek- tualëve më të persekutuar, Çfarë del nga këto shembuj? A nuk të kujtojnë thënien e një filozofi të lashtë «Sa jam gjallë unë, egziston edhe bota» që, e konvertuar për rastet tona, do të thotë. «Sa jam në krye të qeverisjes, ka edhe demokraci, në të ku- ndërt ka vetëm diktaturë», Qofsha i gabuar në ar- syetimet e mia dhe u uroj të gjithë politikanëve tuaj të preferuar suksese në politikë, veçse nuk dëshiroj që ato tu ngjajnë gozhdave në politikën shqiptare, as hijeve që ndjekin dhe as Bankos të Shekspirit,

Së treti, nuk pajtohem me idenë e ndarjes së lëvizjes tonë demokratike në katër etapa të cilën ju e pranoni si një ligj të përgjihshëm historiko-sho- qëror. Po ta pranojmë këtë ligj, atëherë ju nuk du- het të shqetësoheni sepse etapa e katërt e tij, pro- gresi, është objektivisht e garantuar! Përveç kësaj kratiko - borgjez francez pasi ai ishte revo- nuk mund të bëhet paralelizmi me revolucionin demo- lucion me dhunë, jo paqësor. Gjithashtu mendoj se pala e humbur duhet të ketë ngritur duart lart dhe të ketë qëndruar kokëulur për njëfarë kohe gjë, që s'po ndodh në vendin tonë. Përkundrazi ka acarim. Së fundi nuk pajtohem as me faktin që in- telektualë të aftë janë vetëm ato që koha ua ka afishuar emrin, i ka bërë disi të njohur, siç janë disa shkrimtarë, gazetarë, bij familjesh me emër politik, apo edhe disa intelektualë që kryesisht morën grada shhkencore në vendet lindore apo pe- rëndimore (kohët e fundit). E sotmja ka mjaft in- telektualë të tjerë të aftë dhe të përkushtuar ndaj kombit, e nesërmja do të nxjerrë edhe më shumë. Një populli nuk i mungojnë kurrë njerëzit e aftë, as politikanët mjafton të jenë të lirë që të orga- nizohen e të veprojnë.

Mendoj se për njerëzit që e pranojnë logjikën si kriterin më të lartë të vlerësimit të gjërave, çdo vepër njerëzore, në përgjithësi nuk është e përsosur. Po qe e tillë, atëherë ajo quhet «mrekulli» dhe bo- ta njeh shumë pak të tilla. Edhe lëvizja jonë de- mokratike nuk i ngjan mrekullisë. Do të më pëlqen- te të përmendja fjalët e presidentit të tashëm të Hungarisë që i tha në një intervistë dhënë një gazetarit tonë të TV: Jemi përpjekur që ti bëjmë gjërat mirë, por nuk dimë me siguri se ku kemi gabuar dhe ku kemi vepruar drejt.

Populli ynë kaq ka mundur të bëjë gjer tani. Padyshim që gabime ka. E mira e do që ti gjesh ato kudo që të jenë. Kjo e rrit shumë besimin po- litik, kjo e shëndosh klimën politike, Besoj se kjo i vlen shumë popullit,

LUIGJ GJOKA